

Regj.nr.1-7152/12

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PEJË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të paraqiturit Muhamet Halitaj, nga fshati Novosellë KK Pejë, për kundërvajtje nga neni 9 lidhur me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar, e në bazë të neneve 30,123,195 dhe 198. al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 16.08.2012, mori këtë:

#### AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse ndaj të paraqiturit: Muhamet Bardh Halitaj, i lindur me 23.02.1967, në fsh. Novosellë KK Pejë, ku edhe banon, me profesion mjek, Delegat në Kuvendin Komunal Pejë, i paraqitur nga Agjencia kundër Korrupsionit në Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 9 lidhur me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar, e konform nenit 198 al.pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet-NË MUNGES TË PROVAVE.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

#### Arsyetim

- Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka parashtruar kërkesën nr.01-2183/2012, të dt. 15.06.2012, për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të paraqiturit Muhamet Halitaj, sepse si zyrtar i lartë publik-Delegat i Kuvendit Komunal në Pejë, brenda afatit të përcaktuar ligjor nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencisë kundër korrupsionit në Prishtinë, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjatë procedurës paraprake dhe grumbullimit të provave është marrë në pyetje i paraqituri i cili në mbrojtjen e vet deklaroj se e ka bërë deklarimin e pasurisë në afatin e përcaktuar ligjor tek Agjencia kundër Korrupsionit në Prishtinë dhe se formularin për deklarimin e pasurisë të plotësuar dhe të nënshkruar e ka dorëzuar tek AKK me datë 30.03.2012, përmes personit të autorizuar-zyrtarit kontaktues të KK Pejë, Nysret Lipa. Gjykatës ia prezantoi Vërtetimin me numër të protokollit 03-2590/12, të datës 30.03.2012, të lëshuar nga AKK me të cilin dëshmon dorëzimin e formularit për deklarimin e Prejardhjes dhe Gjendjes së Pasurisë.

Nga të lartcekurat, kundër të paraqiturit në vështrim të nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet është **PEZULLUAR** procedura kundërvajtëse, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U vendos në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Pejë Regj.nr.1-7152/12, dt 16.08.12.

#### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi ka të drejtë Ankese parashtruesi i kërkesës kundërvajtëse, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi nëpërmes të kësaj Gjykate.

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA ZA PREKRENE IZ OBLASTI	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. DPK/DMP	Br. Prot. 03-3126/12
Nr. l. faq.	Data
Broj stranica 01	Datum 07-08-2012
Nr. pages	Date
PRISHTINE	

